

# **Klima e Investimeve dhe Formalizimi në Sektorin e Turizmit**

**Sekretariati i Këshillit të Investimeve**


**Takim Konsultativ me Biznesin**

**Vlorë, Shtator 2018**

# Objektivi i Konsultimeve me Biznesin

- Vlerësimi i ndikimit të informalitetit në Turizëm në konkurueshmërinë dhe klimen e investimeve në sektor;
- Ndikimin e politikave fiskale dhe atyre sektoriale në formalizimin e sektorit;
- Konsultimi me biznesin i problematikave të hasura në këtë sezon turistik dhe validimi i gjetjeve të anketimit
- Identifikimi, në bashkëbisedim me biznesin, i masave mbështetëse në funksion të zhvillimit të sektorit;

# Informacion për kampionin




- Anketimi është zhvilluar në nivel kombëtar, të dhënat kanë nivel besimi statistikor 95%;
- Kampioni është ndërtuar bazuar në listën e bizneseve që operojnë në sektorin e turizmit sipas Autoriteteve Tatimore;
- Bizneset nga rajoni i Vlorës që i janë përgjigjur pyetësorit përfaqësojnë 22% të kampionit të bizneseve anketuara.

# Karakteristikat e Bizneseve të Anketuara në Vlorë

Bizneset Sipas Xhiros	Frekuenca (ne %)	Bizneset sipas no. Punësuarve	Frekuenca (ne %)	Bizneset Sipas Kapitalit te Themelimit	Frekuenca (ne %)
5 – 8 milionë ALL	38.2%	1 - 4 punonjës	52.9%	Pa Pergjigje	23.5%
8 - 14 milionë ALL	5.9%	10-49 Punonjes	14.7%	Të huaj	5.9%
Deri në 5 milionë ALL	38.2%	5-9 punonjës	32.4%	Të përbashkët	0.0%
mbi 14 milionë ALL	17.6%	mbi 50 punonjes	0.0%	Vendas	70.6%


- Struktura të mesme po forcohet në krahasim me bizneset e vogla familjare;
- Rajoni i Vlorës ka strukturë të sektorit të përafërt me atë kombëtare, bizneset me xhiro mbi 14 Mio ALL janë me frekuente në rajon krahasuar me nivelin kombëtar.
- Në rajon bizneset me kapital të huaj zënë 6% të bizneseve të sektorit.

# Kontrolli Tatimor, Vizita Tatimore dhe Inspektimet




- *Gjatë 2018, frekuenca e kontrolleve të plota tatimore, është raportuar më e ulët krahasuar me 2017, ndërkohë që vizitat tatimore javore, të planifikuara dhe lajmëruara kanë qënë më prezente;*
- *I Njëjti fenomen raportohet edhe në Vlorë*
- *Mesatarisht janë raportuar 1-3 vizita, kontrolle ose inspektime nga autoritet tatimore.*
- *Gjate 2018, në Vlorë janë raportuar mesatarisht 2 kontrolle tatimore, 1-Vizite fiskale dhe 2-Inspektime Tatimore*
- *Bizneset në Vlorë kanë raportuar raste ekstreme vizitash tatimore (deri në 45 inspektime tatimore për biznes)*

# Perceptimi i Bizneseve në Vlorë për Inspektorët Tatimore



# Perceptimi i Bizneseve Në Vlorë për Aspekte të raportit të inspektimit/kontrollit tatimor



# Kontrolli Tatimor, Vizita Tatimore dhe Inspektimet



- Ka një perceptim të përgjithshëm për moderimin dhe përmirësimin e komunikimit të inspektorëve;
- Aftësitë e tyre profesionale dhe qartësia e raporteve dhe akteve të kontrollit perceptohen nga bizneset si aspektet më të dobëta të inspektorëve tatimorë;
- *Për Vlorën etika dhe komunikimi i inspektorëve është vlerësuar më pak nga aspektet e profesionalizmit;*
- Shkallë ndërgjegjësimit mbi sistemi e riskut të moderuar një ne tre biznese është në dijeni të sistemit të riskut si bazë për përzgjedhjen e biznesit për inspektim apo vizitë tatimore;
- Për Vlorën: vetëm 23.5% e bizneseve ne Vlorë deklarojnë se janë në dijeni të sistemit të riskut, vetëm 17.6% e bizneseve kanë deklaruar se kanë marrë informacion dhe trainim nga administrata tatimore.

# Nga anketimi në shkallë kombëtare rezulton se:

- 71.6% e të intervistuarve kanë deklaruar se përballen me konkurrencë të padrejtë nga bizneset që janë të pa formalizuara
  - *73.5% e bizneseve në rajonin e Vlorës kanë deklaruar se përballen me konkurrencë të padrejtë nga biznese të paformalizuara*
- 26.9% e bizneseve (ne nivel kombetar) deklarojnë se kanë aktivitet ekonomik të paformalizuar
  - *20.6% e bizneseve në rajon deklarojnë se kanë aktivitet informal,*
- 11% e bizneseve kanë marrë masa për të formalizuar aktivitetin në nivel kombëtar
  - *11.8% e bizneseve në rajon kanë ndërmarrë masa për formalizimin e aktivitetit*
- 21% e bizneseve konfirmojnë që ka diskutime në nivel sektori për të përmirësuar dhe formalizuar aktivitetin
  - *23.5% e bizneseve në rajonin e Vlorës deklarojnë se kanë diskutuar me përfaqësues të sektorit mbi formalizimin e aktivitetit ekonomik*
- Informaliteti shfaqet kryesisht në format si shmangie taksash, punësim jo i formalizuar apo dhe biznese të parregjistruara
  - *Në rajon punësimi informal dhe mosregjistrimi janë deklaruar si format më të hasura të aktivitetit ekonomik të pa formalizuar në sektorin e turizmit*



# Arsyet pse bizneset ndërmarrin aktivitet jo të formalizuar Nivel Kombëtar vs. Rajoni Vlorës





## Tre Faktorët më të rëndësishëm të kuotuar:

- Konkurrenca e pandershme nga aktiviteti joformal
- Praktikat korruptive
- Taksat dhe tarifatat lokale

## Tre Faktorët më të rëndësishëm të kuotuar:

- Konkurrenca e pandershme nga aktiviteti joformal
- Praktikat korruptive
- Barra Fiskale


# Ndikimi i uljes së TVSH-së në biznes



- Ulja e TVSH-së ka sjellë përmirësim të investimeve në nivel kombëtar, për rajonin e Korçës TVSH-ja ka mundësuar formalizimin e biznesit dhe punësimit;
- *Ulja e çmimit si rezultat i TVSH-se ka qënë më frekuent në Vlorë, po ashtu dhe investimet për përmirësim të produktit turistik.*

# Perceptimi mbi klimën e biznesit

Vlerësimi mesatar i klimës së investimeve



- Është modeste pjesa e bizneseve që e konsiderojnë shumë favorizuese klimën e biznesit.
- Elementë të klimës së investimeve në turizëm që kanë nevojë të përmirësohen - Kredimarrja dhe burimet njerezore.